



---

**BASHKIA DIMAL**

**Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të  
varfëra dhe të pa favorizuara**

**Objekt: Punime rikonstruksioni e riparimi në banesa ekzistuese**

**Specifikimet Teknike**

## Seksioni 1. SPECIFIKIME TË PËRGJITHSHME

### PËRSHKRIMI I PRONËS.

Pronat ku do të ndërtohen objektet e banimit një kat ndodhen në territorin e bashkisë Dimal, në fshatra të ndryshëm ku jetojnë familje në kushte të vështira dhe me banesa të cilat janë me probleme strukturale dhe nuk mund të rikonstruktohen.

Ndërtesat do të rindertohen për ti ardhur në ndihmë familjeve në nevojë dhe me probleme sociale.

Janë parashikuar ndërtesa një katëshe për arsye se familjet me këtë kubature i plotesojnë kushtet e strehimit dhe qytetarët do të ndërtojnë në pronën e tyre.

Banesat ekzistuese janë tejet të amortizuara e të ndërtuara me materiale të ndryshme si me mur guri me plithare, me kallëma etj. duke e bërë të pamundur jetesen normale në to.

Banesa ekzistuese është e shkatërruar dhe do të priset tërësisht. Një pjesë e materialeve të banesës që do të priset do të përdoret për ndërtimin e ri.

Ndërtimi i Objektivit "Godinë banimi nje kat" është projektuar të ndërtohet me mure mbajtes tulle me kollona antisizmike dhe e mbuluar me çati ne menyre që te mos cënohen elementet e një banese me parametra normale por edhe duke pasur parasysh që objekti të ketë një kosto sa më të ulët ndërtimi.

Objekti do të jetë i përbërë nga një kat banim me sipërfaqe ndërtimore deri ne 60 m<sup>2</sup> me një ambient gatim + ndënje, një dhomë gjumi, një tualet dhe një koridor dhe do të mbulohet me çati.

Trualli i ndërtimit është tokë argjile e fortë me fortësi mbajttese deri ne 1.8 kg/cm<sup>2</sup> në tabanin e themelit të plintit, për çdo rast të kundërt, detyrimisht do të bëhet ndryshim në anën konstruktive të themeleve nga projektuesi.

Themeli do te realizohet me themel te vazhduar dhe plinta per kollonat antisizmik ndersa kollonat do te armohen me hekur periodik  $\phi$  16 sipas percaktimeve te pasqyruara ne projektin konstruktiv.. Lartesia maksimale e objektit eshte 4.7 m, lartesia e katit do te jete 2.9 deri 3.05m .

Muret perimetrare do të realizohen me tulla mbajtëse me përmasa 12x14x25cm. Çatia do të realizohet me 4 kullime, me trare të dukshëm dekorative dhe me të gjitha shtresat drurësore dhe mbrojtëse nga agjentët atmosferike, temperatura dhe reshjet, do të realizohet sipas specifikimit teknik te paraqitur ne projekt.

Brezi beton/arme do të ndërtohen me beton marka c-16/20 të armuar me hekur  $\phi$ 12 punues dhe hekur  $\phi$ 6 montues, stafa do të bëhet me hekur  $\phi$ 8 çdo 10 cm, sipas zgjidhjes në projekt të detajuar,

Arkitrarët e dyerve dhe dritareve do të bëhen të derdhur në vend me mbështetje 25cm (shkelje në mur) me përmasa 25x25cm të armuar me 6φ14 me beton marka c-12/15.

***Shtresat e dyshemesë do të bëhen me “ Shtresë me pllaka granili te zakonshme, 30x30 cm” e ndryshuar në ngjyrë sipas shërbesës së ambientit. pllakat do të shtrohen me drejtues horizontal. suvatimet e brendshme do të realizohen me llaç bastar (gëlqere + llaç) Hyrja ne sheshin endertimit.***

Sipërmarrësi duhet të organizojë punën për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe më pas të spostojë dhe ta rivendosë çdo rrugë hyrje që do të duhet në lidhje me zbatimin e punimeve. Çvendosja do të përfshijë përshtatjen e zonës me çdo rrugë hyrje, qëndrushmërie dhe të kullimit të ujrave sipërfaqësore të njejte me atë që ekzistonte përpara se Sipërmarrësi të hynte në Shesh.

### ***Piketimi i punimeve***

Sipërmarrësi, me shpenzimet e tij duhet të bëjë ndërtimin e modinave dhe të piketave siç kërkohet, në përputhje me informacionin bazë të Punëdhënësit, dhe do të jetë përgjegjës i vetëm për përpikmërinë.

Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës për të kontrolluar dhe verifikuar informacionin bazë që i është dhënë dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij nëse një informacion i tillë është i mangët, jo autentik ose jo korrekt. Ai ndërkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punëdhënësi, dhe në asnjë rast nuk i jepet e drejta të bëjë ndryshime në vizatimet e kontratës , për asnjë lloj kompensimi për korrigjimet e gabimeve ose të mangësive. Sipërmarrësi do të furnizoje dhe mirëmbaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale të tjera të tilla dhe të japë asistencë nëpërmjet një stafi të kualifikuar siç mund të kërkohet nga Punëdhënësi për kontrollin e modinave dhe piketave.

Sipërmarrësi do të ruajë të gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, të bëra ose të vendosura gjatë punës, të mbulojë koston e rivendosjes së tyre nëse ato dëmtohen dhe të mbulojë të gjitha shpenzimet për ndreqjen e punës së bëra jo mirë për shkak të mosmirëmbajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim të këtyre pikave të vendosura, modinave dhe piketave.

Përpara çdo aktiviteti ndërtimor, Sipërmarrësi do të ketë linjat e furnizimit me uje dhe energji elektrike të vendosura në terren, të drejtën e kalimit të qartë dhe të sheshuar, gati për fillimin e punimeve. Çdo punë e bërë jashtë akseve, kuotave dhe kufijve të treguara në vizatime ose të mosmiratuara nga Punëdhënësi nuk do të paguhet, dhe Sipërmarrësi do të mbulojë me shpenzimet e tij gërmimet shtesë.

### Bashkëpunimi në zonë

Ndërtimi do të bëhet në zona të kufizuara. Sipërmarrësi duhet të ketë veçanërisht kujdes në:

- a) Nevojën për të mirëmbajtur shërbimet ekzistuese dhe mundësitë e kalimit për banorët dhe tregëtarët që janë në zonë, gjatë periudhës së ndërtimit.
- b) prezencën e mundëshme të kontraktorëve të tjerë në zonë me të cilët do të koordinohet puna

E gjithë puna, do të bëhet në një mënyrë të tillë, që të lejojë hyrjen dhe përballimin e të gjithë pajisjeve të mundëshme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij, stafin e Punëdhënësit si edhe të çdo punonjësi që mund të punësohet në zbatim dhe/ose punimet në zonë ose pranë saj për çdo objekt që ka lidhje me Kontratën ose çdo gjë tjetër.

Në përgatitjen e programit të tij të punës, Sipërmarrësi gjatë gjithë kohës do të bëjë llogari të plotë dhe do të koeporojë me programin e punës së Kontraktorëve të tjerë, në mënyrë që të shkaktojë një minimum interference me ta dhe me publikun.

### *Njësitë matëse*

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratën janë njësi metrike në mm, cm, m, m<sup>2</sup>, m<sup>3</sup>, Km, N

(Njuton), Mg (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si “. “.

### *Grafiku i punimeve*

Kontraktuesi duhet t'i japë supervisorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në ndërtim deri në mbarim të punës.

Informacioni që mban supervisorin duhet të përfshijë: vizatime që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të godinës dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim; detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme; plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë përndërtim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim, detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo tëkualifikuar si dhe supervizionin e punimeve. Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga supervisorin, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga supervisorin gjatë zbatimit të punimeve.

### *Punime të gabuara*

Çdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë.

## **SEKSIONI 2. PUNIME PRISHJEJE**

### *Pastrimi i kantierit*

Ne fillim të kontrates, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndertuese, dhe të largojë të gjitha përgjethjet e mbeturinave të tjera.

### *Mbrojtja e godinave, rrethimeve dhe strukturave*

Gjate kryerjes së punimeve prishese, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojnë godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishese. Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anet e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet patur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rena e materialeve ose të projektohet në mënyrë të tillë që mos të përbejë rrezik për njërezit, strukturat rrethuese dhe pronat publike të çdo lloji. Kur përdoren mekanizmat për prishje si: vinç, ekskavatore hidraulik dhe thyes shkëmbinjsh të bëhet kujdes, që një pjesë e tyre të mos kenë kontakt me kabllot telefonik ose elektrik. Kontraktori duhet të informojë në fillim të punës autoritetet përkatëse, në mënyrë që, ato të marrin masa për levizjen e kabllave.

### *Gërmim dheu*

Gërmim dheu themele ose për punime nentokesore, deri në thellësinë 1,5 m nga rrafshi i tokës, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të thatë ose të lagur (argjile edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gure etj) Përforcimin e çfarëdo marke dhe rezistence, mbushjen e pjesëve që mbeten bosh pas realizimit të themeleve me materialin e Gërmimit të kryer me krah, si dhe spostimin brenda ambientit të kantierit.

### *Siguria në punë*

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë :

a) Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet

b) Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me ekperiencë

b) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit

Gjatë punës prishëse të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete

mbrojtëse si: helmata, syze, mbrojtëse, mbrojtëse veshësh, dhe bombola frymëmarrjeje.

### ***Mbrojtja e ambientit***

Sipërmarrësi, me shpenzimet e veta, duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera. Mos plotësimi i kësaj klauzole në bazë të evidentimit nga Investitori mund të çojë në ndërprerjen e kontratës.

### ***Transporti dhe magazinimi i materialeve***

Transporti i çdo materiali nga Sipërmarrësi do të bëhet me makina të përshtatshme të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantjeri. Të gjitha materialet që sillen nga Sipërmarrësi, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatshme për ti mbrojtur nga rreshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Investitori në çdo kohë.

### ***Pastrimi përfundimtar i zonës***

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Sipërmarrësi, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e tërë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme.

## **SEKSIONI 3. PUNIME NDERTIMORE**

### ***PUNIMET E BETONIT.***

Ne të gjitha rastet, raportet e agregatit në beton duhet të jenë të tilla që të prodhohen perzjerje të cilat do futen neper qoshe edhe cepa të formave si dhe perreth perforcimit pa lejuar ndarjen e materialeve.

### ***Matja e materialeve***

Inertet e imeta dhe të trasha do të peshohen ose të maten me kujdes në përshtatje me kërkesat e Manaxherit të Projektit. Ato nuk do të maten në asnjë rast me lopata apo karroca dore.

Cemento do të matet me thasë 50 kg dhe masa e perzjerjes do të jetë e tillë që grumbulli i materialeve të pershtatet për një ose me shumë thasë.

Prerja, perkulja dhe vendosja e armimit do të jetë pjesë e punës brenda cmimit njësi të vendosura për armimin e hekurit të furnizuar dhe të venë në punë.

Saldimi i shufrave të forcuara me perjashtim të rasteve të shufrave të fabrikuar me saldim nuk do të lejohet. Shufrat e forcuara të ekspozuara për shtesa të ardhshme, do të mbrohen nga korrozioni dhe rreziqe të tjera.

### ***Betoni i derdhur në vend***

#### *Kërkesa të përgjithshme për betonin*

Betoni është një përzierje e çimentos, inerte të fraksionuara të rërës, inerte të fraksionuara të zhavorit dhe ujit dhe substancave të ndryshme për fortësinë, përshkueshmërinë e ujit dhe për të bërë të mundur që të punohet edhe në temperatura të ulëta sipas kërkesave dhe nevojave teknike të projektit.

### **Materialet**

#### *Përbërësit e Betonit*

Përbërësit e betonit duhet të përmbajnë rërë të larë ose granit, ose përzierje të të dyjave si dhe gurë të thyer. Të gjithë agregatët duhet të jenë pastruar nga mbeturinat organike si dhe nga dheu. Pjesa kryesore e agregateve duhet të jetë me formë këndore dhe jo të rrumbullakët.

Përbërësit e betonit duhet të kenë

çertifikatën që vërteton vendin ku janë marrë ato.

#### *Çimento*

Kontraktuesi është i detyruar që për çdo ngarkesë çimentoje të prurë në objekt, të paraqesë faturën e blerjes e cila të përmbajë: sasinë, emrin e prodhuesit si dhe çertifikatën e prodhuesit dhe shërben për të treguar që çimentoja e secilës ngarkesë është e kontrolluar dhe me analiza sipas standarteve.

Për më shumë detaje në lidhje me markën e çimentos që duhet përdorur në prodhimin e betoneve, shiko në pikën 4.1.4, pasi për marka betoni të ndryshme duhen përdorur marka çimento të ndryshme.

#### *Uji për beton*

Uji që do të përdoret në prodhimin e betonit duhet të jetë i pastër nga substancat që dëmtojnë atë si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe substanca të tjera organike. Në përgjithësi, uji i

tubacioneve të furnizimit të popullsisë (uji i pijshëm) rekomandohet për përdorim në prodhimin e betonit.

**Beton marka 250** me inerte, konsistencë 3 – 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 400, 370 kg, rërë e larë 0,43 m<sup>3</sup>, granil 0,69 m<sup>3</sup>, ujë 0,18 m<sup>3</sup>.

### **Elemente dhe nën- elemente betoni**

#### *Arkitrare të derdhur në vend*

Arkitrarët realizohen në të gjithë gjerësinë e muraturës me mbështetje min. 25 cm mbi shpatullat anësore, me lartësi të ndyshme në varësi të hapësirës së dritës, të armuar në mënyrë të rregullt dhe sipas udhëzimeve në projekt, të përgatitur nga beton M 200 duke përfshirë skelat e shërbimit, kallëpet, përforcimet, hekurin e armaturës dhe çdo përforcim tjetër për mbarimin e punës.

#### *Breza betoni*

Realizimi i brezit, në të gjithë gjerësinë e muraturës poshtë dhe lartësi prej 15 deri në 20 cm, i armuar sipas NTZ dhe STASH, i realizuar me betonin të prodhuar në vepër, i shtuar në shtresa të holla të vibruara mirë, në beton M 150 deri te M 200 me inerte dhe siç tregohet në vizatime, duke përfshirë kallëpet, përforcimet, hekurin e armaturës, skelat e shërbimit ose skelerinë, si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

#### *Kollona*

Kollona betoni, të armuara në mënyrë të rregullt dhe sipas udhëzimeve në projekt, deri në lartësinë 4 m i

realizuar me betonin të dhënë në vepër, i shtruar në shtresa të holla të vibruara mirë, betoni, betoni m-200 me dozim sipas betonit marka 200 me inerte dhe siç tregohet në vizatime, duke përfshirë skelat e shërbimit, kallëpet, përforcimet, hekurin e armaturës, si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës.

### **Kallëpet dhe finiturat e betonit**

#### *Përgatitja e kallëpeve*

Kallëpët përgatitën prej druri osë prej metali dhe janë të gatshme ose përgatiten në objekt.

Sipërfaqet e kallëpeve që do të jenë në kontakt me betonin, do të trajtohen në mënyrë të tillë, që të sigurojnë shqitje të lehtë dhe mosngjitjen e betonit në kallëp gjatë heqjes. Përpara



ripërdorimit, të gjitha kallëpet dhe sipërfaqet e tyre që do të jenë në kontakt me betonin, duhen pastruar me kujdes pa shkaktuar ndonjë dëmtim në sipërfaqen e kallëpit.

## **Hekuri**

### *Materialet*

Përgatitja e çelikut për të gjitha strukturat e betonit dhe komponentët e metalit, që duhen prodhuar në kantier, duke konsideruar çelikun që plotëson të gjitha kërkesat e projektit dhe pa prezencën e ndryshkut, në format dhe përmasat sipas vizatimeve dhe standarteve tekniko-legale për bashkimin, lidhjen dhe duke e shoqëruar me çertifikatën e prodhuesit për të verifikuar që çeliku plotëson kushtet e kërkuara që nevojiten për punë të tilla dhe duke përfshirë të gjitha kërkesat e tjera jo të specifikuara.

### *Vendosja dhe fiksimi*

Hekurat do të pozicionohen siç janë paraqitur në projekt dhe do të ruajnë këtë pozicion edhe gjatë betonimeve. Për të siguruar pozicionin e projektit ata lidhen me tel 1,25 mm ose kapëse të përshtatshme.

## **RIFINITURAT**

### **Rifiniturat e mureve**

#### *Punime suvatimi.*

Suvatimi i sipërfaqeve horizontale dhe vertikale, realizuar me llac bastard M-25 përfshin sprucimin e mureve dhe tavaneve me llac cimentoje të lenget për permiresimin e ngjytjes së suvase dhe rforcimin e sipërfaqeve të muratës duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë fund plotësisht sprucimit.

Suvatimi i jashtëm do të bëhet me suva të zakonshme ku do të dominojë ngjyra e bardhë. Materialet që duhet të përdoren në punimet elektrike, duhet të kenë të gjitha cilësitë e fortesisë, kohezgjatjes, izolimit dhe funksionimit të mirë e të rezistojnë veprimeve mekanike, grryese, termike dhe lageshtisë. Janë në përgjegjësi të sipermarresit montimet dhe cmontimet të pjesëve perkatese për kryerjen e provave. Të gjithë aksesoret duhet të vendosen në vepe nepermjet kutive të instaluar me llac cimentoje M 1:2, me dozim m<sup>3</sup>, cimento 400 kg.527; rere e lare fino dhe uje duke u kujdesur vecanerisht që instalimi i kutive të mesiperme të bëhet rrafsh me murin në lidhje me sipërfaqet e suvatuara dhe të veshura në mënyrë që të mos verifikohen dalje ose futje të tepërta në kuti. tubi fleksibel duhet të futet në kutite që të

mos demtoje kavot që hyjne në kuti. Është i ndaluar përdorimi i llacit të allcise ose lendeve të ngjashme për vendosjen e kutive, mbylljen e kanaleve etj.

#### *Suvatimi i brendshëm*

Sistemimi i sipërfaqeve ku është e nevojshme për suvatime për nivelimet e parregullive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin. Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Sprucimi i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin. Suvatim me drejtues i realizuar nga një shtresë me trashësi 2cm llaçi bastard m-25 me përmbajtje për m<sup>2</sup>: rërë e larë 0,005 m<sup>3</sup>; llaç gëlqereje m- 1 : 2, 0.03 m<sup>3</sup>; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin. Në përfundim duhet të largohen të gjitha mbeturinat nga objekti.

#### *Suvatim i jashtëm*

Stukim dhe sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin.

Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Sprucimi i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin. Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim për m<sup>2</sup>: rërë e larë 0,005 m<sup>3</sup>; llaç bastard 0.03 m<sup>3</sup>; çimento 400, 7.7 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

### ***Punime Bojatisje***

Bojatisje me bojrahidro plastike ne ambjentet e brendshme. Ngjyra do te vendoset nga investitori ne momentin e zbatimit te projektit.

Bëhet astarimi me astarë të gatshëm me bazë akrilike ose plastike sipas tipit të bojës që do të përdoret , bojatisje në dy duar me bojë në një distance kohë të nevojshme për tharje të dorës së parë , sipërfaqja të jetë uniforme dhe pa ngjolla.

Stukim dhe lëmimin e suvasë të fashinuar më parë me stuko sintetik për të patur të gatshme dhe në mënyrë perfekte sipërfaqet për lyerje.

#### ***Lyerje me bojë hidro plastike***

Proçesi i lyerjes me bojë hidro plastike i sipërfaqeve të mureve të brendshme kalon nëpër tre faza si më poshtë: 1-Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet. Para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me ane të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për paralyerje. Në rastet e sipërfaqeve të patinuara bëhet një pastrim i kujdesshëm i sipërfaqes. Para fillimit të proçesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen. (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. 2- Paralyerja e sipërfaqes së brendshme të pastruar. Në fillim të proçesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me vinovil të holluar (Astar plastik). Për paralyerjen bëhet përzierja e 1 kg vinovil me 2.5-3 litra ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë. Norma e përdorimit është 1 litër përzierje vinovil me ujë duhet të përdoret për 20 m<sup>2</sup> sipërfaqe. 3- Lyerja me bojë hidro plastike e sipërfaqeve të brendshme. Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës plastike e cila është e paketuar në kuti 5 litërshe. Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje i hidhet pigmenti derisa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizioni i punimeve dhe pastaj bëhet lyerja sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë plastike e holluar duhet të përdoret për 4-5 m<sup>2</sup> sipërfaqe. Kjo normë varet ashpërsia e sipërfaqes së lyer.

### **PUNIME SHITESASH**

#### ***Shtrese me pllaka gres porcelanato/majolike***

“ Shtresë me pllaka granili te zakonshme, 30x30 cm” Ngjyra e tyre do të përcaktohet nga investitori. Pllakat që do të zgjidhen duhen parë dhe verifikuar në amballazhim. Pllakat do të nën shtrohen me kollë , pasi të jenë verifikuar nivelimi i saj me një proces verbal. Nivelimi të

bëhet nga një specialist topograf me një tolerance jo më shumë se 5mm në të gjithë godinën. Pllakat do të nenshtrohen me fuga që formojnë një kënd 45 grad me akset e godinës. Akset diagonal të pllakave duhet të jenë rigorozisht paralele me akset e godinës dhe shtrimi i tyre duhet të jetë pandërprerje nga koridori nëpër dhoma, pra fugat të jenë në vazhdimësi.

Dysheme me pllaka gres porcelanato. Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin. Pllakat do të jenë gres porcelanato nje brumeshe, luçidato, cilesine e pllakes qe gjendet ne objekt. Pllakat do të jenë cilesore importi, sipas standarteve europiane. Pllakat do të shtrohen me kolle, mbi nje siperfaqe grezo me llaç çimento.

Në ambientet me lagështirë (ËC, banjo e dushe) duhet të vendosen pllaka të klasës I, që e kanë koeficientin e marrjes së ujit < 3 %. Për këtë duhet që përpara fillimit të punës, kontraktori të paraqesë tek Supervizori disa shembuj pllakash, së bashku me çertifikatën e tyre të prodhimit dhe vetëm pas aprovimit nga ana e tij për shtrimin e tyre, sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve të dhëna nga prodhuesi.

### ***Punime hidrosanitare***

#### *Shkarkimi i ujrave*

Per shkarkimin e ujrave do te perdoren tubo e rakorderi pvc sipas project-preventivit,do te vendosen pileta dyshemeje brenda cdo tualeti. .

Te gjitha lidhjet duhet te kryhen qe te mos rrjedhin nga ndonje shkak.

ËC jane prej porcelani (allafrengje) e cilesise se pare, e furnizuar dhe e vendosur ne veper duke perfshire gjithe aksesoret dhe punimet per vendosjen, kasete shkarkuese e cilesise se pare e kompletuar me furnizimin dhe vendosjen si dhe cdo punim tjeter .

Furnizim dhe vendosje tub polipropilen  $\varnothing 1/2$  "-  $\varnothing 1$ "", lavaman porcelani +grup uji me tape, me zinxhir, sifonit, tubave etj. duke perfshire cdo detyrim tjeter.

Materialet dhe aparatet qe do te perdoren ne punimet hidrosanitare duhet te kene fortesine, kohezgjatjen, izolimin dhe funksionimin e mire dhe duhet te jene te tilla qe t'i rezistojne veprimeve mekanike, gryese,termike dhe lageshtires per ato qe duhet te jene ne **kontakt me te gjate punes.**

### **NDERTIM CATIJE**

Mbulimi do të realizohet me çati vendi me tjegulla. Ndertimi i catise do të realizohet me material druri të lehtësuar dhe mbulesa me tjegulla marsejeze të kuqe. I gjithë materiali i drurit duhet të jete meseksion katror, sipas shenimeve teknike në fletën e vizatimeve që shoqëron projektin, i

stazhionuar dhe te mos permbaje lageshti jashte normave teknike. Materiali I drurit do te mbulohet me leter katerma me dy duar per te eleminuar pikimet nga shiu mbi taracen ekzistuese.

### **ULLUQE HORIZONTALE**

Ulluqet horizontale do te kene nje pjerresi prej 1% per largimin e ujrave. Ulluk horizontal me llamarine prej çeliku te xinguar me trashesi jo me te vogel se 0.8 mm, i formuar nga pjese te modeluara me mbivendosje minimale 5 cm, te salduara ne menyre te rregullt me kallaj, me bord te jashtem 2 cm me te ulet se bordi i brendshem, te kompletuara me pjese speciale per gryken e hyrjes. Ulluku horizontal i modeluar sipas udhezimeve ne projekt, duhet te jete i lidhur me tel xingato me hallka te forta te vena maksimumi ne 70 cm. Te gjithë ulluqet prej betoni duhet te hidroizolohen me guaino nga ana e brendeshme e tyre. Ulluqet e vendosura ndermjet çatise dhe parapetit do te jene prej llamarine te xinguar, sipas detajeve te vizatimit.

### **ULLUQE VERTIKALE**

Ulluqe vertikale per shkarkimin e ujrave te çatise ne gjendje jo te mire duhet te çmontohen dhe te zevendesohen me ulluke te rinj. Ulluke vertikale per shkarkimin e ujrave te çatise dhe tarracave te ndertuar me llamarine prej çeliku te xinguar, me trashesi jo me te vogel se 0.6 mm dhe me diameter 10 cm. Ne çdo ulluk duhet te mblidhen ujrat e nje siperfaqeje te çatise ose tarraces jo me te madhe se 80 m<sup>2</sup>. Ulluket duhet te vendosen ne pjesen e jashtme te nderteses me ane te qaforeve perkatese prej çeliku te xinguar, te fiksuar mbi parapete çdo 2 m. Ujerat e tarraces duhet te mblidhen nepermjet nje pjate prej llamarine te xinguar, i riveshur me guaine te vendosur ne flake, me trashesi 3 mm, te vendosur ne menyre te terthorte ndermjet muratures dhe parapetit, me pjerresi 1% dhe me nje vaske te xinguar ne forme gjeometrike sipas udhezimeve ne projekt. Pjesa fundore e ullukeve per lartesine 2 m, duhet te jete PVC dhe e mberthyer fort me ganxha hekuri si dhe kuba poshte duhet te jete e kthyer 90 grade.

### **HEQJE DYERSH E DRITARESH**

Heqje dyersh dhe dritaresh te çfaredo lloji, perfshire kasen, telajot etj. Por me spostimin e materialit qe rezulton brenda ambientit te kantierit, duke perfshire perzgjedhjen e mundeshme (I percaktuar nga D.P.) dhe grumbullimin ne nje vend te caktuar ne kantier per perdorim.

## **DITARE DURALUMINI**

Furnizimi dhe vendosja e dritareve, siç pershkruhet ne specifikimet teknike me dimensione te dhena nga kontraktori, perbehen nga material alumini, profilet e te cilit jane sipas standarteve Europiane EN 573-3 dhe jane profile te lyera perpara se te vendosen ne objekt. Korniza e dritares do te kete nje dimension sipas permasave ekzistuese. Te gjitha punet e lidhura me muraturen dhe te gjitha kerkesat e tjera per kompletimin e punes duhet te behen me kujdes. Nje model i materialeve te propozuara do te shqyrtohet nga supervizori per nje aprovim paraprak.

## **DYER TE BRENDESHME**

Dyer te brendeshme me dru te forte ose Tamburato importi Furnizimi dhe instalimi i dyerve te brendshme prej druri Pise dhe te trajtuara me mbulesa mbrojtese te drunjte, dimensionet e te cilave jepen nga porositesi, perbehet nga: - nje kase e bere me dru pise te stazhionuar (me trashesi 4 cm) e trajtuar me nje mbulesa mbrojtese te drunjte, e dimensionuar sipas gjereses se murit, (duke marre parasysh edhe rritjen prej mbuleses se murit) mberthehet fuqishem ne mur me vida hekuri dhe me llaç çimento - Nje kornize e kases se drurit qe fiksohet tek kasa e drurit e dhene me siper pas suvatimit dhe lysterjes. Per dyert e dhena ne Vizatimet Teknike, korniza do te sigurohet me mentesha dhe ankerat e çelesit per te gjitha llojet e dyerve (dyer me kase, dyer pa kase me drite ne pjesen e siperme, etj). - Pjeset hapese te dyerve i kemi disa tipe: tamburate dhe me dru masiv. Kasat fikse te dyerve do te bashkohen me kornizat pasi te kete perfunduar suvatimi dhe lysterja. Kanatet e xhamit do te vendosen tek korniza e dyerve dhe do te mberthehen ne tre pika ankorimi. Gjithashtu do te vendosen edhe bravat dhe dorezat. Mbushja ndermjet kases dhe murit te nderteses do te behet duke perdorur material plastiko-elastik, pasi te jene mbushur me materialin e duhur hidroizolues.

## **PUNIME ELEKTRIKE**

Specifikime elektrike te veçanta Aksesoret Instalimi elektrik duhet te jete siç eshte treguar ne projekt dhe skica, pershkruar ne specifikimet teknike ose udhezimet e projektuesit. Montimi duhet te perfshije furnizimin me energji elektrike te cilesuara dhe te ofruara si edhe paisjet e ofruara dhe te instaluara nga te tjeret. Pika e furnizimit te paisjeve duhet te jete kutia terminale furnizuese ne pajim Kanale t dhe aksesoret Instalimet elektrike mund te behen ne dy menyra Nen suva ne tuba PVC fleksibel Mbi suva ne kanaleta PVC Aksesoret e instalimeve nen suva jane: Tubat fleksibel PVC te dimensioneve te ndryshme ne varesi te dimensionit dhe F numrit te telave qe do te futen ne te. Kutite shperndarese Kutite per fiksimin e prizave ose te çelsave te future ne

suva. Te gjitha keto vendosen para se te behet suvatimi I plote I siperfaqeve. Per kryerjen e instalimeve elektrike te future ne suva duhet te ndiqet rradha e punes se vijon: Hapja e kanaleve ne mur me dimension te tille qe te vendoset lirshem tubi fleksibel dhe me thellesi te tile qe te mos dale mbi nivelin e suvase Vendoset tubi fleksibel dhe kuta prej PVC te cilit provizorisht fiksohen me allçi Pasi eshte kryer suvatimi, futen telat ose kablot, me ane te udhezuesit te tyre, te cilat duhet te hyne lirshem dhe te lihet ne ted y krahet nje sasi e mjaftueshme per kryerjen e lidhjeve dhe montimeve. Cdo vend pune eshte i pajisur me korrent nga 3 priza (15 cm nen parvazin e dritares) (ngarkesa e instalimit e kalkuluar 250Ë).

***-Sistemim territori.***

Perfshin shtrimin me pllaka sheshi ne hyrje te godines ,shtrimin me pllaka trotuar dhe largimin e te gjitha inerteve te shkaktuara nga prishja e objektit ekzistues.

***Rekomandojmë: Të gjitha punimet ndërtimore të zbatohen sipas kushteve teknike të zbatimit të ndërtesave. grupi i projektimit do të asistojë në të gjitha operacionet e punimeve ndërtimore të këtij objekti.***

Punoi: Drejtoria e Planifikimit